



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 363, datë 14.09.2021

PËR
TRANSFERIMIN E PÛRKOHSHËM ME PËLQIM NË GJYKATËN E RRETHIT
GJYQËSOR KRUIË TË GJYQTARES ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61 dhe në shkronjën “c”, të nenit 86, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 9, të Vendimit të tij nr. 23, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi kërkesat për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm të gjyqtarëve znj. {...} dhe z. Gjergji Baçi dhe vlerësoi përmbushjen nga ata të kriterëve të transferimit të përkohshëm me pëlqim, mbi propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë të gjyqtares znj. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.
2. Efektet juridike të transferimit të përkohshëm fillojnë më datë 20.09.2021.
3. Gjyqtarja {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
4. Gjyqtarja {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që ka në gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, si gjyqtar i vetëm ose kryetar i trupit gjykues, për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore dorëzohen menjëherë prej saj.
5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së transferuar përkohësisht znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR